

REPUBLIKA E KOSOVË / REPUBLIC OF KOSOVO
 VLADE E KOSOVË / VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVO
 MINISTERIA PËR KOMUNITETE DHE KTHIM
 MINISTRY FOR COMMUNITIES AND RETURN
 MINISTERIARSTVO ZA ZAJEDNICE I POVRATAK

Njësia Org. / Jedn. Org. / Unit: 01

Nr./D/No. 1780 Data/Çmimi/Date: 10/07/2025

Nr. Fajde/No. Stranica/Pagin: 2

PUSHE KOSOVË/A



REPUBLIKA E KOSOVË / REPUBLIC OF KOSOVO
 ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
 NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE

DATE PRANIPAR/PREZUAR:
 DATUM PRILJEN/OSTAVLJEN: 11-07-2025
 DATE RECEIVED/SUBMITTED:

Njësia Org. Org. Jedn. Org. Unit	Shif. klasif. Klasif. Kod Class. Code	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	Nr. Fajde No. Stranica No. Pages
03	47	1232	7

Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria -Vlada-Government

Ministria për Komunitete dhe Kthim /Ministarstvo za Zajednice i Povratak /Ministry for
 Communities and Return

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Nga: Nenad Rasic , Ministër – Ministria për Komunitete dhe Kthim

Data: 09.07.2025

PLANI I VEPRIMIT PËR ZBATIMIN E
 REKOMANDIMEVE

Të dhëna në raportin e Zyrës Kombëtare të
 Auditimit për vitin 2024

Të nderuar,

Në bazë të raportit të Zyrës Kombëtare të Auditimit për raportet financiare të MKK-së për vitin 2024 dhe rekomandimeve që janë paraqitur në të, kërkoj që në afatin sa më të shkurtër të fillojnë përgaditjet dhe implementimi i planit të veprimit për rekomandime , si dhe formimi i komisionit për përcjelljen e implementimit të rekomandimeve , dhe zyrtarët përgjegjës për implementim.

Gjithashtu kërkoj që të gjitha rekomandimet të Zyrës Kombëtare të Auditimit të përfundohen deri në kohën e cekur në planin e veprimit që është i bashkangjitur.

Pas përfundimit të afatit për realizim , komisioni për përcjelljen e rekomandimeve duhet të përgadisë raportin e parë, i cili duhet të dorëzohet deri me datën 15.10.2025 , dhe pas kësaj të paraqes raporte në baza mujore rreth shkallës së realizimit të rekomandimeve.

me respekt

Nr.	Komponenta e auditimit (kapitulli)	Gjetja	Rekomandimi	Punët që janë planifikuar të ndërmerren	zyrtari/ët përgjegjës	Data e planifikuar e zbatimit të rekomandimit	Komentet
1	Çështja B1 -Mbivlerësimi i pasurisë kapitale	Neni 12 i Rregullores MF Nr. 02/2013 Për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare në Organizatat Buxhetore përcakton mënyrën e regjistrimit, kategorizimit	Ministri duhet të siguroj se janë ndërmarrë masat e duhura për të siguruar bartjen e plotë të pronësisë së pasurisë tek	Do të merren të gjitha masat lidhur me azhurnimin e plotë të regjistrimit të pasurisë duke u bazuar ne	ZKA, ZKF, DFSHP si dhe Zyrtari i pasurisë.	Dhjetor 2025	Këtij plani të veprimit i është bashkangjitur: një letër nga Ministri drejtuar

		<p>dhe kalimit të pronesisë me rastin e blerjes apo ndërtimit të pasurisë përmes bashkëfinancimit. Tutje, neni 13 i kësaj rregullore përcakton se "Të gjitha transaksionet e krijuara gjatë blerjes apo ndërtimit të pasurisë financiare për organizatat tjera buxhetore duhet të regjistrohen në regjistrat e organizatës financuese në kategorinë e investimeve në vijim. Në momentin kur pasuria jofinanciare i ka kaluar të gjitha rregullat dhe procedurat e dorëzimit, organizata buxhetore financuese do të mbyll llogarinë e investimeve në vijim. Më tej, sipas nenit 6.1 "Cdo organizatë buxhetore duhet të krijojë dhe azhurnoj regjistrin e pasurive jo financiare që i ka në menaxhimin e saj. Vlera e prezantuar e pasurisë kapitale dhe jo kapitale ne PVF ishte mbivlerësuar për 954,797€ si rezultat i mos</p>	<p>komunat dhe njëkohësisht të bëjë azhurnimin e regjistrit të pasurisë duke i larguar investimet në vijim të cilat tyashmë i takojnë përfituesve tjerë, po ashtu të largoj nga regjistrat e pasurisë shpenzimet operative në mënyrë që pasuritë të prezantohen drejt dhe saktë në PVF. Për më tepër të siguroj se aplikohet një analizë e mirëfilltë e regjistrit të pasurive, në mënyrë që saldo e bartur në vitin vijues të ofroj informata të sakta.</p>	<p>Rregulloren 02/2013 si dhe në bashkëpunim me MFPT, në mënyrë që të kemi një prezantim të drejtë në PVF.</p>			<p>Sekretarit të Përgjithshëm, vendimi i Sekretarit të Përgjithshëm për formimin e komisionit për të monitoruar zbatimin e rekomandimeve dhe letër nga Sekretari i Përgjithshëm drejtuar Drejtorëve të departamenteve për zbatimin e rekomandimeve.</p>
--	--	---	--	--	--	--	---

		bartjes së pasurive te pala përfituese dhe kategorizimit jo të drejtë.					
2	Çështja B2 - Kompensimi i punonjësve pa vijueshmëri të plotë në punë .	Neni 9 i Rregullores (QRK) Nr.1072022 Për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve”, përcakton se “Cdo zyrtar publik është i obliguar të shënohet në librin e vijueshmërisë në punë ose në regjistrin elektronik, varësisht se cilën e ka në përdorim institucioni”. Po ashtu, neni 17.2 i Rregullores së re (QRK) Nr.04/2024 Për orarin e punës, pushimet dhe vijueshmërinë e zyrtarëve publik, përcakton se “ Vijueshmëria në punë e zyrtarit publik evidentohet përmes regjistrimit në sistemin elektronik që administrohet në përputhje me	Ministri duhet të ndërmerr të gjitha veprimet për të siguruar kushte pune dhe vijueshmërinë e rregullt në punë të këtyre punonjësve, duke bërë monitorimin e vazhdueshëm siç parashihet me aktet ligjore.	Do të vazhdojnë përpjekjet me MPB për të siguruar hapësira dhe kushte pune në të katërt Komunat Veriore. Krahas kesaj, do të vazhdojmë përpjekjet për zgjidhje alternative, përfshirë këtu iniciativën e nisur për bashkëpunim me katër Komunat Veriore, me qëllim të shfrytëzimit të hapësirave të tyre të punës-akomodimin e stafit apo ndonjë zgjidhje tjetër të përshtatshme.	Ministri dhe Sekretari i MKK-së në bashkëpunim me Ministrin dhe Sekretarin e MPB, Kryetaret e Komunave Veriore, Drejtori i DFSHP-së dhe Udhëheqësi i DBNJ.	Dhjetor 2025	Këtij plani të veprimi i është bashkangjitur: një letër nga Ministri drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm, vendimi i Sekretarit të Përgjithshëm për formimin e komisionit për të monitoruar zbatimin e rekomandimeve dhe letër nga Sekretari i Përgjithshëm drejtuar Drejtorëve të

		<p>legjislacionin përkatës në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.</p> <p>"Tutje, neni 17.3 përcakton se "Kur nuk është e mundur për arsye teknike, vijueshmëria në punë e zyrtarit publik bëhet përmes regjistrimit në librat evidentues".</p> <p>Me vendimin nr. 06/39 të datës 22.07.2015, Ministria ishte e obliguar ti sistemoj 19 punonjës të komunitetit serb me qëllim të integrimit të tyre në sistemin e Republikës së Kosovës. Sipas konfirmimeve nga zyrtarët relevant për të njëjtit nuk kishte dëshmi të vijueshmërisë në punë.</p> <p>Shpenzimi për vitin 2024 për këtë kategori ishte 112,558 €. Kjo dukuri po vazhdon të jetë prezente ndër vite edhe pse është raportuar në vazhdimësi nga</p>					<p>departamenten për zbatimin e rekomandimeve.</p>
--	--	--	--	--	--	--	--

		raportet tona të auditimit. Për vitin 2025 ministria kllishte filluar të mbajë evidencat për vijueshmërinë në punë, ceshtje kjon e cila do të vlerësohet me procedurat audituese të vitit 2025.					
3	Çështja B3 - Mangësi në procesin e inventarizimit/vlerësimit të pasurive	Neni 19.4.3 i Rregullores – Nr. 02/2013 për Menaxhimin e pasurisë jo financiare përcakton se cdo fund vit duhet të bëhet krahasimi i gjendjes së inventarizuar me gjendjen e regjistrave të pasurive jo financiare. Ndërsa neni 21 i po kësaj rregulloreje ka përcaktuar kërkesat për vlerësimin e pasurive jo financiare. Ministria kishte bërë inventarizimin e pasurisë për vitin 2024, por raporti i	Ministri duhet të sigurojë që komisioni për inventarizimin e pasurisë ka informata të plota për të gjithë pasuritë në përdorim dhe në pronësi të ministrisë, dhe pas inventarizimit duhet të bëhet harmonizimi me regjistrin e pasurive për të korrigjuar gabimet e mundshme në regjistrin e	Do të merren të gjitha masat paraprake për tu siguruar që anëtarët e komisionit për inventarizim të pajisen me të gjitha informatat e nevojshme për procesin e inventarizimit (do të mbahen takime informuese dhe trajnime sipas nevojës për procedurat e inventarizimit). Do të formohet komisioni për	ZKA, DFSHP-së, ZKF dhe Divizioni i Logjistikës dhe IT-së.	Dhjetor 2025	Këtij plani të veprimi i është bashkangjitur: një letër nga Ministri drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm, vendimi i Sekretarit të Përgjithshëm për formimin e komisionit për të monitoruar zbatimin e rekomandimeve dhe

		<p>inventarizimit nuk është harmonizuar me regjistrin e përgjithshëm të pasurisë. Rrjedhimisht, nuk dihet diferenca mes gjendjes së kontabilitetit dhe inventarizimit. Po ashtu, nuk ishte kryer vlerësimi i pasurive jo financiare sipas kërkesave të rregullores për menaxhimin e pasurive. Kjo kishte ndodhur për shkak të mos ndërmarrjes së masave të mjaftueshme në pajtim me kërkesat e rregullores që ndërlidhen me detyrat e komisionit të inventarizimit/vlerësimit.</p>	<p>pasurive, në mënyrë që prezantimi i pasurive në PFV-të e vitit 2025 të jetë i saktë.</p>	<p>vlerësimin e pasurisë jo financiare dhe komisioni për tjetërsim të pasurisë jashtë përdorimit, ashtu siç parashihet në Rregulloren nr.02/2013, dhe pas përfundimit të procesit, do të bëhet harmonizimi me regjistrin e pasurive.</p>			<p>letër nga Sekretari i Përgjithshëm drejtuar Drejtorëve të departamenteve për zbatimin e rekomandimeve.</p>
--	--	--	---	--	--	--	---

